



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 459/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkitazi me ankesën e koalicionit politik Aleanca për Kosovën e Re (AKR) e cila i drejtohet Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 13.12.2010, mori:

### **VENDIM**

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e koalicionit politik Aleanca për Kosovën e Re (AKR)

### **ARSYETIMI**

Më datë 12.12.2010 PZAP-i ka pranuar ankesë nga koalicioni politik AKR dega në Prishtinë, e cila i drejtohet KQZ-së, pasi me date 12.12.2010 në Shkollën Filllore “Dardania” në Pejë komisionarët kanë raportuar se ka pasur mungesë të llampave identifikuese.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove materiale, me propozim që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshte:

*59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e palejuar**

Ne baze te dispozitave te lartpërmendura, PZAP-i vlerëson se ankesa e AKR-se paraqitur kundrejt KQZ-së ne lidhje me mungesën e llampave identifikuese gjatë ditës se zgjedhjeve 12.12.2010, nuk është nen juridiksionin e tij. Prandaj për këtë arsye dhe ne pajtim te dispozitave ligjore te cekura me larte si dhe ne pajtim te nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 459/2010 më datën 13.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit**

**Muharrem Shala**

